



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA			
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA			
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH			
Njësia Org Org.Jedimica Org Unit	09	Nr.Prot: Broj Prot: Prot.No	05-7863
Nr.i faqeve Br.stranica No.pages	- 07 -	Data: Datum: Date:	06/12/2023
Prishtinë / a			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

KONTRATË PUBLIKE

FURNIZIM

Titulli: "Furnizim me dysheka mjekësore dhe pajisje mjekësore për
ISSH"

Numri i kontratës¹: 206-23-11583-1-3-6/C478

Numri i Prokurimit: 206-23-11583-1-3-6

Operatori ekonomik: " **MADEKOS SH.P.K.**

NUI: 811560293

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

MINISTRIA E SHËNDETËSISË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëzën anë; dhe

MADEKOS SH.P.K., Vragoli (Magjistrallja Prishtinë-Pejë), Fushë Kosovë, (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Furnizim me dysheka mjekësore dhe pajisje mjekësore për ISSH me numër identifikues: 206-23-11583-1-3-6

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Furnizim me dysheka mjekësore dhe pajisje mjekësore për ISSH
- 1.2 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrimin nga të dyja palët dhe përfundon pas kryerjes së furnizimeve.
- 1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë nga data e marrjes së urdhërësës nga AK
- 1.4 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë: Në objektin ISSH
- 1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP (Detyra e Dërguar e Paguar).

Nr.	Emërtimi I Artikullit dhe Specifikat Teknike	Njësia	Sasia	ÇMIMI PËR NJËSI PA TVSH €	TVSH (%)	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €
1	DYSHEK SHTRATI ME MBËSHTJELLËS REZISTENT NDAJ UJIT Dimensionet Gjerësia: 900 mm Gjatësia: 1900 mm Lartësia: 140 mm Veçoritë standarde Mbulesë; i papërshkueshëm nga uji. Mbulesë; antibakteriale. Mbulesë; zinxhir-patent në dy anët. Shkumë; 22 kg/m3 dendësia. (Ekuivalent)	Copë	30	84.75	0.18	100.00	3,000.00€
2	DYSHEK ANTI DEKUBIT Furnizimi me energji elektrike: 110V/220V/50Hz Dalja e ajrit: 5.5 liter/min Diapazoni i presionit: 30 mmHg – 220 mmHg Koha e ciklit: 6 min Konsumi i energjisë: 5W Madhësia: 200cm (L) x 90cm (W) x 7.0cm (H) 130 qelizat e fluskave Ventilimi dhe kapakët fundor të diponueshëm PVC trashësia: 0.30 mm Komplet i riparimit dhe zorra e përfshirë Kapaciteti i peshës: 120kg,Ekuivalent)	Copë	10	18.52	0.08	20.00	200.00 €

3.	<p>Aparat për koncentrim dhe prodhim te Oksigjenit</p> <p>Modeli OLV-10 L ose(Ekivalent) Norma e rrjedhjes 0-10 L/min Pastërtia e oksigjenit $\geq 93\% \pm 3\%$ (1LPM) Konsumi i energjisë elektrike 800VA Presioni i prodhimit 20Kpa-60Kpa Niveli i zërit më pak se 50db Pesha neto 20kg Dimensionet 344*306*565(mm) Aplikimi i produktit Kujdesi mjekësor</p>	Copë	1	787.04	0.08	850.00	850.00€
4.	<p>EKG 3 kanalshe (Electrocardiograph)</p> <p>Dimenzionet: 220x153x55 mm (L x W x H) Peshat: < 0,6 kg</p> <p>Regjistrimi i prizave standarde 12 EKG duke ruajtur sinjalin e EKG-së njëkohësisht nga të 12 drejtime gjatë regjistrimit automatik, së bashku me datën dhe orën e ekzaminimit, cilësimet e filtrit, kohën e regjistrimit të ekzaminimit dhe, sipas dëshirës, të dhënat e pacientit, në memorien e brendshme.</p> <p>Printimi i regjistrimit automatik të EKG-së nga memoria e brendshme, në grupe prej tre prizash printimi i analizës, interpretimi i ekranit të ekzaminimit automatik të EKG-së me 1, 3, 6 ose 12 incizime EKG me LED, printimi i 1 ose 3 EKG-së të grupit të përzgjedhur:</p>						
	<p>Duke i bashkangjitur emrit të pacientit printimit të EKG-së. Printimi i EKG-së në tastierë alfa-numerike membranore me 1 ose 3 kanale, menyja grafike me çelësa funksionale e shfaqur në ekran për përdorim të lehtë duke përdorur analizën dhe interpretimin automatik të tastierës në përputhje me EN 60601-2-25 (data e të dhënave CSE) - interpretimi i varur nga mosha dhe gjinia e memorjes së pacientit të ekzaminimeve të fundit automatike, me një kufi nga 5 në 1000 deri në 130 ekzaminime automatike në matjen e vazhdueshme të rrahjeve të zemrës (HR) në modalitetin e baterisë dhe shfaqja e zbulimit automatik të kompleksit QRS të përshtatur për funksionimin e drejtpërdrejtë në një linjë energjie me zemër të hapur Filtri i ndërhyrjes: 50 Hz, 60 Hz filtri i ndërhyrjes së muskujve; filtra të disponueshëm: filtra të linjës konturore 25 Hz, 35 Hz, 45 Hz; filtra të disponueshëm: 0,15 Hz, 0,45 Hz, 0,75 Hz, 1,5 Hz zbulimi i shkëputjes së elektrodës, i</p>	Copë	1	735.19	0.08	794.00	794.00 €

<p>pavarur për çdo kanal. Kanal i përzgjedhshim për të zbuluar rrahjet e zemrës trashësinë e linjës së printimit të formave valore EKG për të zgjedhur: prezantim normal ose i guximshëm i kthesave në paraqitjen standarde ose paraqitjen e Cabrera menu shumëgjuhëshe porta e jashtme e komunikimit USB për të lidhur një PC dhe softuerin CardioTEKA, për transmetimi ne kohe-reale i kohës së sinjalit EKG sinjalizimi akustik i rrahjeve të zbuluara mbrojtje kundër zbulimit të pulsit të defibrilimit dhe prezantimit të pulseve stimuluese në ekzaminimin automatik të printuar me printimin e të dhënave të pacientit dhe të dhënave të klinikës funksionet e kursimit të energjisë së baterisë</p> <p>Pajisje standarde Elektroda gjymtyrësh, 4 copë Elektroda gjoksi, 6 copë Kablllo EKG KEKG-30R lidhës i rrymës mjekësore, M12-15 Letër RB1 58 mm e gjerë (1 rrotull) Xhel për EKG Manuali i funksionimit</p>						
Totali (DDP):						4,844.00€

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: 4,844.00€; [katërmijëtetëqindkatërdhjetë katër euro].

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetnija pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

3.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të shërbimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *shërbimeve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën kompetente në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

²Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Menaxheri i kontratës është: Avni Mehmeti

Telefoni: 0290-389-029

E-mail: Avni.S.Mehmeti@rks-gov.net





Personi kontaktues nga OE: Ardian Buzuku

Telefoni: 049/555-461

E-mail: made-kos@hotmail.com

Për Autoritetin Kontraktues

Për Furnizuesin

Emri:	Berat Marmullaku	Emri:	VISAR HODA
Pozita:	Udhëheqës i Div. te Prokurimit	Pozita:	MENAXHER
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	06.12.2023	Data:	06.12.2023
Vula:		Vula:	



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Policies me Nr. **120652**

Për **Ministria e Shëndetësisë**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **MADEKOS SH.P.K.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Furnizim me dysheka mjekësore dhe pajisje mjekësore për ISSH**

Nr. prokurimit: 206-23-11583-1-3-6

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t`i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **484.40€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **484.40€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 180 ditë kalendarike prej **06.12.2023** deri më **03.06.2024**

Data lëshimit: 06.12.2023

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.